



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
“ISA BOLETINI”

Rruga Ukshin Kovaçica, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
Tel: +381-28535725/535727

Kryesues i Këshillit Drejtues
Prof. dr. Ali Topalli

Nr. Prot. 1185
Dt 24.09.2020

Në bazë të nenit 23, paragrafi 1.6, alineja 1.6.2 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini”, Këshilli Drejtues, në mbledhjen e mbajtur më 18.9.2020, miratoi:

RREGULLOREN

për të ardhura personale të personelit akademik, shtesat për funksione, honorarët dhe komisionet e përhershme në Universitetin e Mitrovicës

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Mjetet për të ardhurat personale shfrytëzohen nga fondi i Buxhetit të Kosovës, nga tarifat e shkollimit dhe pagesat tjera të cilat i bëjnë studentët, nga pagesat dhe për shërbime komerciale dhe shërbime tjera dhe donacionet, dhuratat dhe ndihma tjera si dhe nga kontratat me organizma kombëtarë, ndërkombëtar publik dhe privat. Nga këto burime financiare paguhen të ardhurat personale dhe kompensimet tjera për personelin akademik dhe jo akademik në marrëdhënie të rregullt pune, si dhe puna mbi normë dhe puna me honorar për personelin akademik të Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini” (në tekstin e mëtejshëm: Universiteti – UMIB).

Lartësia e të ardhurave personale caktohen në bazë koeficienteve dhe thirrjeve të koduara në shërbimin qendror për të ardhurat sipas kodimit unik për tërë arsimin në Kosovë.

II. DISPOZITAT E VEÇANTA

Neni 2

Shërbimi për financa i Universitetit e bën përllogaritjen e të ardhurave personale dhe pagesave tjera në bazë të vendimit të Senatit të Universitetit për angazhimin e personelit akademik për çdo vit akademik, përkatësisht raporteve të dorëzuara deri më datën 5 të muajit vijues.

Mbi këtë bazë menaxheri, përkatësisht personi i autorizuar jep urdhër për realizimin e pagesave sipas kontratave të cilat lidhen me të punësuarit me rastin e angazhimit.

Neni 3

Me personelin akademik në marrëdhënie të rregullt pune, në pajtim me dispozitat ligjore lidhet kontratë pune: me normë të plotë; me gjysmë normë dhe me honorarë (mbinormë). Universiteti mund të lidh kontratë pune me honorar me personelin akademik më së shumti për një vit akademik, në rastet kur konkursi i publikuar për këto vende nuk realizohet me sukses.

Në rastet kur personelit akademik i ka skaduar kontrata e punës (kategorisë së mësimdhënësve sipas nenit 156 dhe 157 të Statutit të Përkohshëm në kohëzgjatje prej 4 vitesh, ligjëruesve, asistentëve dhe lektorëve sipas nenit 158, 159 dhe 160 të Statutit të Përkohshëm në kohëzgjatje prej 3 vitesh) si pasojë e shtyrjes përkatësisht vonesave në përfundimin e procedurave të rizgjedhjes apo avancimit, të njëjtëve iu vazhdohet kontrata në thirrjen aktuale për një vit akademik, përkatësisht deri në marrjen vendimit përfundimtar nga ana e Senatit lidhur me konkursin përkatës.

Personeli në marrëdhënie të rregullt pune nuk mund të ketë kontratë tjetër të punësimit me normë të plotë brenda apo jashtë universitetit.

III. SANKSIONET

Neni 4

1. Personeli akademik, i cili mungon nga procesi mësimor do të sanksionohet me heqje proporcionale të pagës (për profesorë – 1 orë mësimi =50 €, për asistentë, 1 orë =25 €).
2. Në rastet kur njëri nga anëtarët e komisioneve recensuese nënshkruan recension në kundërshtim me dispozitat Statutit, rregulloret e brendshme të Universitetit apo legjislacionin në fuqi, të konstatuar nga Senati, rasti dërgohet për trajtim në Këshill të Etikës.

IV. PERSONELI AKADEMIK

Neni 5

Për personelin akademik të punësuar në Universitetet përcaktohet norma javore e orëve dhe lartësia e pagës sipas titujve akademik si në vijim:

1. Personeli akademik me normë të plotë të punës

a. Titulli	Orë/javë	Euro
Profesorët e rregullt	6 orë/javë	1429.54
Profesorët e asocuar	6 orë/javë	1283.34
Profesorët asistent	6 orë/javë	1137.14
Profesorët e shkollave të larta	6 orë/javë	1137.14
Ligjëruesit	6 orë/javë	990.00
Lektorët	10 orë/javë	844.73
Asistentët	10 orë/javë	772.50

- b. Asistentit, lektorit dhe ligjëruesit me gradë shkencore Dr. i shtohet edhe një pagesë në lartësi prej 50 € mbi pagën bazë të përcaktuar si në pikën 1 (a).

2. Kompensimi funksional sipas posteve udhëheqëse (bruto €)

a. Posti - funksioni	Paga	Shtesa	Totali
Rektori	1429.54	500,00	1.929,54
Prorektori	1429.54	450,00	1.879,54
Kryesuesi i KD		250,00	250,00
Zëvendës kryesuesi i KD		200,00	200,00
Anëtarët e KD nga radhët e UMIB-it	1429.54	200,00	1.629,54
Anëtarët e KD-së nga radhët e MASHT-it		200,00	200,00
Sekretari i përgjithshëm	1429.54	000,00	1.429.54
Dekani	1429.54	350,00	1.779.54

Prodekani	1429.54	250,00	1.679.54
Drejtori i Qendrës së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë	1429.54	250,00	1.679.54
Shefi i departamentit		70,00	70,00
Koordinatori Qendror për zhvillim të cilësisë		250,00	250,00
Koordinatori Qendror për bashkëpunim ndërkombëtar		250.00	250.00
Koordinatori Qendror për kërkime shkencore		250.00	250.00
Koordinatori për zhvillim të cilësisë në fakultete		70,00	70,00

b. Anëtarëve të Këshillit Drejtues iu takojnë edhe mëditjet në bazë të vendimit të MASHT-it nr. prot. 2178, ref. Nr.260/01B të datës 29.06.2015.

3. Kompensimi për orët e mbajtura mbi normë dhe honorarë

Për profesorët e Universitetit (Prof. i rregullt, prof. asoc. Prof. ass.)	25 euro/orë
Për profesorët nga Universitetet e rajonit	40 euro/orë
Për ligjërues, lektor, asistent,	13 euro/orë

Rektorit, prorektorit, anëtarit të Këshillit Drejtues nga radhët e UMIB-it dhe dekanit, në qoftë se mbajnë mësim, iu takon kompensimi deri në 6 orë në kuadër të mbi normës.

Prodekani ka për obligim të mbajë 3 orë të normës së paraparë sipas thirrjes që mbanë, ndërsa 3 orë i paguhen në kuadër të mbi normës.

Kompensimi për mësim jepet për tetë muaj gjatë vitit akademik.

4. Norma e orëve mbi normë dhe honorar

- Personeli akademik i Universitetit në marrëdhënie të rregullt (Prof. Dr; Prof. Asoc. Dr; Prof. Ass. Dr; dhe Ligjërues) që janë në marrëdhënie të rregullt pune në universitet mund të mbajnë deri në 5 orë në javë.
- Personeli akademik që ka dy marrëdhënie pune, brenda apo jashtë Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini”, (primare apo sekondare) nuk mund të marrë orë mbi normë.
- Personeli administrativ i universitetit nuk mund të angazhohet në procesin mësimor të UMIB – it.
- Për personelin akademik nga pika a. në mungesë të normës së plotë në studimet bachelor, norma mësimore duhet të plotësohet edhe me orët nga studimet master dhe atë 1 orë ligjërata në studime master që do të jetë e barabartë me 1 orë ligjërata në studimet bachelor, plotësimi i normës bëhet edhe me orë të cilat do t’i mbajë në njësitë tjera akademike brenda UMIB – it.
- Lektori, asistenti që janë në marrëdhënie të rregullt pune në universitet mund të mbajnë deri në 8 orë në javë.
- Për personelin akademik nga pika b, njësia akademike është e obliguar që t’i sigurojë orë mësimore deri në normën e plotë. Në rastin kur mësimdhënësit i ofrohen orë për plotësimin e normës dhe ai nuk e pranon, pagesa i bëhet proporcionalisht me numrin e orëve të cilat i mbanë.

g. Orët mbi normë nuk mund t'i jepen personelit akademik i cili e ka normën e plotë, përderisa nuk i plotësohet norma e plotë mësimdhënësve, përkatësisht asistentëve në marrëdhënie të rregullt pune nga lëmi i njëjtë.

4.1 Në rast kur mësimdhënësit nuk i plotësohet norma për secilin semestër, ai normën e plotëson me orët e mbajtura mbi normë nga semestri tjetër.

4.2 Përfundimisht, nëse mësimdhënësit nuk mund t'i plotësohet norma e plotë e orëve të ligjëratave, atë mund ta plotësojë edhe me orë të ushtrimeve në përpjesëtim 1 me 1 por jo më shumë se 2 orë ushtrime nga tërësia e normës.

Përfundimisht nga pika 4.2, mësimdhënësit, me një arsyetim të veçantë me shkrim nga dekani i fakultetit, rektori mund të marr vendim për pagesë të orëve të ushtrimeve në proporcion 2:1.

4.3 Asistentëve nuk mund t'iu kompensohen orët e ligjëratave. Në raste të veçanta me kërkesë të Këshillit të Fakultetit dhe dekanit të njësisë akademike kur konstatohet se nuk ka mundësi të angazhimit të personelit adekuat, asistenti me Mr. sc. apo Msc. që ka të regjistruar doktoraturën mund të angazhohet për mbajtjen e ligjëratave.

4.4 Pagesa për kategorinë si në pikën 4.3 do të bëhet në bazë të thirrjes akademike.

4.5 Personeli akademik që nuk ka marrëdhënie të rregullt pune në universitet por që angazhohet nga jashtë universiteti, mund të mbajë deri në 5 orë ligjëratë në javë, ndërsa asistenti deri në 8 orë ushtrime në javë.

4.6 Angazhimi i personelit akademik me orë mbinormë dhe me honorar në Universitet bëhet në bazë të vendimit të Senatit të Universitetit me propozim të njësisë akademike, më së voni deri me 30 shtator të vitit vijues.

V. KRITERET THEMELORE PËR FORMIMIN E GRUPEVE PËR PUNË MËSIMORE

Neni 7

1. Përcaktimi i grupeve të numrit të studentëve në studimet bachelor, sipas specifikave të fakulteteve, bëhet duke u bazuar në tabelat e mëposhtme (tabela 1 dhe tabela 2).
2. Nuk lejohet formimi i dy ose më shumë grupeve, nëse numri i studentëve për grup është:
 - Më i vogël se 20, për grupin e parë të fakulteteve;
 - Më i vogël se 10, për grupin e dytë të fakulteteve.
3. Përfundimisht, për shkak të mosakreditimit institucional në vitin akademik 2019/2020, për studentët e regjistruar në vitin akademik 2018/2019 do të lejohet formimi i grupeve edhe nën minimumin e lejuar për vitin e dytë, respektivisht vitin e tretë dhe të katërt, deri në përfundim të studimeve për këtë gjeneratë të studentëve.

Tabela. 1. Grupi i I – rë

Fakulteti	Ligjëratë	Ushtrime
Fakulteti Juridik	Oblig. deri në 100, Zgjedh. >20	Oblig. deri në 50, Zgjedh. >20
Fakulteti Ekonomik	Oblig. deri në 100, Zgjedh. >20	Oblig. deri në 50, Zgjedh. >20

Tabela. 2. Grupi i II – të

Fakulteti	Ligjëratë	Ushtrime
Fakulteti i Gjeoshkencave	Oblig. deri në 80, Zgjedh. > 10	Teori-30/zgj.10/Lab.Ob.15/Zgj.10
Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore	Oblig. deri në 80, Zgjedh. >10	Teori-30/zgj.10/Lab.Ob.15/Zgj.10
Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike	Oblig. deri në 80, Zgjedh. > 10	Teori-30/zgj.10/Lab.Ob.15/Zgj.10

Fakulteti i Edukimit	Oblig. deri në 80, Zgjedh. > 10	Teori-50/zgj.10/Lab.Ob.15/Zgj.10
----------------------	---------------------------------	----------------------------------

Sqarim

O – Obligative

Z – Zgjedhore

L – Laboratorike

T – Teorike

T – Teorike dhe obligative 30

Z >10

L >15

Z >10

Neni 8

1. Përcaktimi i grupeve të numrit të studentëve në studimet master, sipas specifikave të fakulteteve, bëhet duke u bazuar në tabelat e mëposhtme (tabela 3 dhe tabela 4).
4. Nuk lejohet formimi i dy ose më shumë grupeve, nëse numri i studentëve për grup është:
 - Më i vogël se 10, për grupin e parë të fakulteteve;
2. Më i vogël se 5, për grupin e dytë të fakulteteve.
3. Nëse numri i studentëve të regjistruar në vitin e dytë është më i vogël se minimumi i përcaktuar në tabelat vijuese, atëherë numri i studentëve të regjistruar përcakton madhësinë e grupit.

Tabela. 3. Grupi i I – rë

Fakulteti	Ligjërata	Ushtrime
Fakulteti Juridik	Oblig. deri në 70, Zgjedh. >10	Oblig. deri në 35, Zgjedh. >10
Fakulteti Ekonomik	Oblig. deri në 70, Zgjedh. >10	Oblig. deri në 35, Zgjedh. >10

Tabela. 4. Grupi i II – të

Fakulteti	Ligjërata	Ushtrime
Fakulteti i Gjeoshkencave	Oblig. deri në 60, Zgjedh. >5	Teori-30/zgj.5/Lab.Ob.10/Zgj.5
Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore	Oblig. deri në 60, Zgjedh. >5	Teori-30/zgj.5/Lab.Ob.10/Zgj.5
Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike	Oblig. deri në 60, Zgjedh. >5	Teori-30/zgj.5/Lab.Ob.10/Zgj.5
Fakulteti i Edukimit	Oblig. deri në 60, Zgjedh. >5	Teori-30/zgj.5/Lab.Ob.10/Zgj.5

VI. LARTËSIA E KOMPENZIMIT PËR PUNIME TË DIPLOMËS

Neni 9

Pagesa për mbrojtje të diplomës në studimet bachelor bëhet si në vijim:

Mentorit 20 euro

Anëtarët e komisionit 10 euro

VII. LARTËSIA E KOMPENSIMIT PËR UDHËHEQJE TË KANDIDATIT NË STUDIMET MASTER

Neni 10

Kompensimi për udhëheqje të kandidatit për studime master bëhet si në vijim:

Mentori 250 Euro

VIII. LARTËSIA E KOMPENSIMIT PËR KOMISIONIN PËR VLERËSIM DHE MBROJTJE TË PUNIMIT TË DIPLOMËS PËR STUDIME MASTER

Neni 11

Kompensimi i komisionit për vlerësim dhe mbrojtje të punimit të diplomës për studentet master bëhet si në vijim :

- | | |
|-----------------------------|---------------|
| 11.1 Kryetari i komisionit | 90 euro |
| 11.2. Anëtarët e komisionit | (2) × 80 euro |

IX. MËNYRA E REALIZIMIT, VERIFIKIMIT DHE MONITORIMIT TË PAGESAVE PËR ORËT E RREGULLTA, ORËT MBI NORMË DHE PROVIZIONET TJERA

Neni 12

Çdo orë e paraqitur për pagesë duhet të arsyetohet me listat e studentëve të pranishëm , të verifikuara nga personi i autorizuar i fakultetit.

Raportet duhet të paraqiten deri më datë 5 të muajit të ardhshëm.

Raportet për orët e mbajtura më të vjetër se 1 muaj nuk paguhen.

Stafi akademik në marrëdhënie të rregullt pune do të paguhet vetëm për orët e mbajtura, por jo më shumë se norma e përcaktuar me këtë rregullore.

X. LARTËSIA E KOMPENSIMIT PËR STUDIME TË DOKTORATËS

Neni 13

Një mësimsdhënës nuk mund të udhëheq më tepër se dy kandidatë për doktoratë brenda një viti akademik.

Kompensimi për studimet e doktoratës bëhet si në vijim:

Neni 12.1.

- a. Kompensimi për orët e mbajtura për grupin e kurseve të përgjithshme
 - 1 orë ligjëratë = 25 € por jo më shumë se 28 orë për semestër.
- b. Kompensimi për orët e mbajtura për grupin e kurseve profesionale
 - 1 orë ligjëratë = 30 € por jo më shumë se 12 orë për semestër

Neni 12.2

- | | |
|--------------------------------------|-------|
| a) Komisioni për vlerësim të punimit | |
| Mentori | 1000 |
| Kryetari i komisionit | 300 € |
| Anëtari i komisionit | 250 € |

Në rastet kur Komisioni për vlerësimin e punimit përbëhet nga mentori dhe komentori, atëherë pagesa do të bëhet si në vijim:

- Mentori 600 €

- Komentori 600 €
- b) Komisioni për mbrojtje publike
Anëtar i komisionit (3) nga 200 €

Neni 12.3.

Për kandidatët të cilët mbrojnë punimin e doktoratës në Universitetin Publik të Mitrovicës dhe kanë anëtar të komisionit jashtë Kosovës, shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit i heqë Universiteti.

XI. Lartësia e kompensimit të komisioneve

Neni 14

1. Kompensimi i komisioneve të renditura si në vijim bëhet në bazë të mbledhjeve të mbajtura, por jo më shumë se për dy mbledhje në muaj.

Komisioni i Studimeve i Senatit.....	50 euro
Këshilli qendror i studimeve të doktoratës.....	50 euro
Komisioni Qendror për Sigurimin e Cilësisë dhe Vlerësimit	50 euro
Këshilli botues	40 euro
Këshilli i Etikës	40 euro
Komisioni i ankesave dhe i parashtresave i Senatit	50 euro
Komisioni për çështje statutare	50 euro
Komisioni recensues (Kryetari).....	50 euro
Komisioni recensues (Anëtar).....	30 euro
Këshilli i studimeve të doktoratës i njësisë akademike	30 euro
2. Kompensimi për anëtarë të Senatit (përfshirë dekanëve dhe menaxhmentit) është në vlerë prej 70 euro në muaj.

XII. DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 15

1. Kjo rregullore hyn në fuqi nga data 18.09.2020.
2. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore, ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues i Universitetit, shfuqizohet çdo rregullore apo vendim lidhur me pagesat të cilat rregullohen me këtë rregullore.

Prof. dr. Ali Topalli

Kryesues i Këshillit Drejtues

